REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

NR ----

DATE_____

PROJEKT – VENDIM

NR. 14 DATË 28/ 01 / 2024

"Per miratimin e organizimit te perkohshem te punonjesve te Agjensise se Sherbimeve publike dhe trajtimit financiar te tyre deri ne finalizimin e plote te krijimit ligjor te kesaj Agjensie"

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" Ligiit Nr. 68/2017, datë 27.04.2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistëmit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; " Ligjit Nr.152/2013, "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar ,Ligji Nr. 7961, datë12.07.1995 " Kodi i Punës I Republikës së Shqipërisë" I ndryshuar, Vendimi Nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndyshime në Vendimin Nr.328, datë31.05.2023, të Këshillit të Ministarve " Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" Vendimi Nr. 421 datë 26.06.2024 " Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 325 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministarve për miratmin e struktures së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zvëndësministrave të funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënrefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administrates publike" të ndryshuar,Ligji Nr. 35/2023 " Për kompetencat dhe caktimin e pagave, trajtimeve te tjera financiare dhe perfitimeve te te punesuarve ne instituconet e administrates publike, si dhe te pages baze minimale ne shkalle vendi",i ndryshuar.

Propozoj:

1.Te miratoje organizimin dhe pozicionimin e perkohshem te punonjesve ne Agjensine e Sherbimeve publike

- Deri ne momentin e perfundimit te procedurave per krijimin e plote ligjor dhe financiar te Agjensise se Sherbimeve publike,punonjesit qe do te transferohen ne kete strukture do te pozicionohen perkohesisht ne zerat dhe pozicionet e planifikuara per Agjensine siap struktures te miratuar me vendim te keshilluit bashkai nr 71 date 27.12.2024 ''Per krijimin e Agjensise se Sherbimeve Publike''

- Ky pozicionim do te jete thjesht adminstrativ dhe per efekt pune nderkohe qe Agjensia ende nuk ka statusin e saj ligjor te pavarur
- Pergjegjesia financiare dhe administrative per keta punonjes do te mbetet ne varesi te Bashkise Devoll!

2.Te miratohet trajtimi financiar i punonjesve nga buxheti I bashksie me fondet ekzistuese ose te propozoje nje ridestinim te e perkohshem te fondeve ne zerat ku eshte e mundur.

- Pagesat e punonjesve do te kryhen nga buxheti i Bashkise Devoll (me kodin e saj financiar) nepermjet zerit te shpenzimeve per pagat dhe sigurimet shoqerore derisa Agjensia te mare kodin institucional dhe te behet funksionale per administrimin e buxhetit te saj!

3.Pershpejtimi i procedurave per krijimin e Agjensise

- Kryetari i bashkise te angazhohet per pershpejtimin e procedurave te hapjes se kodit institucional duke bashkepunuar me institucionet perkatese!

4.Afati i zbatimit te ketij vendimi

- Ky vendim do te jete i vlefshem deri ne perfundim te krijimit ligjor te Agjensise dhe transferimin formal te kopetencave dhe pergjegjesive financiare!

5 .Per zbatimin e ketyre vendimeve ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës.

6.Ky Vendim hyn në fuqi pas shpalljes ,sipas ligjit 139/2015 ''Per veteqeverisjen vendore'',neni 55 ,pika 6.

Drejtor i Menaxhimit te Burimeve Njerëzore
A/Rushitaj

Sekretar i Pergjithshem
A.Seferkolli

Per zyren juridike
E.Avdo

KRYETARI I BASHKISE
EDUARD DURO

Adresa: Bashkia Devoll,Lagjia nr 1 Rr "24 Tetori" nr 9,Bilisht Tel.Fax: +355 811 2 2288 e-mail bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

Nr 279 prot Date 28.01.2025

RELACION PER PROJEKT VENDIMIN

"Per miratimin e organizimit te perkohshem te punonjesve te Agjensise se Sherbimeve publike dhe trajtimit financiar te tyre deri ne finalizimin e plote te krijimit ligjor te kesaj Agjensie"

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" Ligiit Nr. 68/2017, datë 27.04.2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistëmit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; " Ligjit Nr.152/2013, "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar ,Ligji Nr. 7961, datë12.07.1995 " Kodi i Punës I Republikës së Shqipërisë" I ndryshuar, Vendimi Nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndyshime në Vendimin Nr.328, datë31.05.2023, të Këshillit të Ministarve " Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emërur, të nëpunësve civilë e të punonjësve administativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" Vendimi Nr. 421 datë 26.06.2024 " Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 325 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministarve për miratmin e struktures së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zvëndësministrave të funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënrefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administrates publike" të ndryshuar,Ligji Nr. 35/2023 " Për kompetencat dhe caktimin e pagave, trajtimeve te tjera financiare dhe perfitimeve te te punesuarve ne instituconet e administrates publike, si dhe te pages baze minimale ne shkalle vendi",i ndryshuar.

Te nderuar keshilltare !

Ky projekt vendim qe po propozojme ka si synim dhe destinacion nje zgjidhje kalimtare dhe te perkohshme per trajtimin e punonjesve te cilet transferohen ne Agjensine e Sherbimeve Publike duke mbeshtetur nje proces te ligjshem dhe te zbatueshem financiarisht deri ne perfundimin formal te krijimit te Agjensise dhe sigurimin e te gjitja procsve ne perputhje me legjislacionin

Per te sqaruar me tej kete nevoje emergjente qe po ju paraqesim disa elemente kyc:

1-Situata aktuale dhe nevoja-

- Agjensia eshte ne proces krijimi ,ajo ende nuk ka perfunduar krijimin e saj ligjor per tu bere nje njesi buxhetore dhe administrative e pavarur(mungesa e kodit institucional dhe aftesise per te trajtuar fonde)
- Punonjesit jane tashme te emeruar pra teknikisht jane ne varesi te bashkise

Keta individe kane kontrata pune dhe te drejta finaciare qe duhet te respektohen pavarsisht mungesave apo vonesave ne krijimin e Agjensise!

- ***Rreziku i voneses ne paga-***

Agjensia nuk mund te perballoje shpenzimin financiar te tyre dhe ne kete rast detyrimi bie mbi bashkine pasi keta punonjes per momentin jane teknikisht ne varesi te bashkise!

2.Arsyeja per te paraqitur kete projekt vendim per keshillin bashkiak?

- Kompetenca mbi buxhetin , strukturen dhe organizimin adminstrativ

Sipas ligjir 139/2015 eshte keshilli bashkiak organi kopetent qe miraton ***:-Strukturen organizative te bashkive dhe njesive ne varesi te saj***
-Destinimin e fondeve dhe ndryshimet buxhetore.

- **-Legjitimeti ligjor**:Kalimi i perkohshem i punonjesve ne pozicionet e planifikuara te agjensise dhe trajtimi financiar i tyre kerkon qe procesi te jete transparent dhe i mbeshtetur nga nje vendim formal i cili shmang:
- Cdo tejkalim te kopetenca te kryetarit te bashkise dhe rrezikun per kundershtime ligjore nga institucionet me objekt kontrollin financiar!

3.Justifikimi ligjor i kesaj zgjidhje

1.Punonjesit jane ende ne varesi te bashkise

Derisa agjensia te behet efektive (me kodin e saj institucional dhe llogarite financiare te saj) punonjesit konsiderohen si pjese e struktures ekzistuese te bashkise sepse:

- Agjensia nuk ka kapacitet te trajtoje pagesat apo administrimin e personelit
- .Bashkia mban pergjegjesine financiare dhe administrative per ta!

2.Perkohshmeria e procesit

Vendimi percakton qarte se pozicionimi ne Agjensi eshte perkohesisht vetem per efekt pagese derisa te perfundoje krijimi i saj ligjor!

3.Mbeshtetje ne ligjin e Menaxhimit Financiar

Ligji 9936 date 26.06.2008'' Per Menaxhimin Financiar '' percakton qarte se perdorimi i fondeve publike duhet te jete transparent dhe i monitoruar
-Me kete vendim te keshilit bdare ashkiak fondet per pagat do te jene te justifikuara ligjerisht deri ne krijimin e zerave te buxhetit te Agjensise .

4.Me ane te ketij procesi synojme te arrijme:

1.Shmangie te vonesave te pagave punonjesve

- Punonjesit do te trajtohen pa nderprerje duke ruajtur te drejtat e tyre dhe duke shmangur mosmareveshjet e mundshme.

2-Siguri dhe transparence per bashkine

Bashkia ruan pergjegjesine e saj ligjore dhe shmang cdo veprim qe mund te konsiderohet si tejkalim kopetencash apo keqmenaxhim financiar!

3.Proces i kontrolluar dhe ligjor

Vendimi i keshillit bashkiak e formalizon kete situate kalimtare duke pershpejtuar krijimin e Agjensise pa shkelje ligjore.

Si perfundim ky projektvendim ka per qellim :
-Pozicionimin e perkohshem te punonjesve ne strukture
-Pagesen e tyre deri ne perfundimin e krijimit te agjensise
-Afatin e vlefshmerise dhe masat per pershpejtimin e krijimit te saj!

Pra ne kete menyre ne po propozojme kete per te garantuar:

- ✓ Respektimin e te drejtave te punonjesve
- ✓ Ligjshmerine e veprimeve financiare dhe administrative
- ✓ Shmangien e vonesave dhe pergjegjesive institucionale

Drejtor I Drejtorise se MBNJ

A.Rushitaj

KRYETARI I BASHKISE
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll,Lagjia nr 1 Rr "24 Tetori" nr 9 Bilisht Tel.Fax: +355 811 2 2288 e-mail bashkiadevoll@gmail.com